

DEKLARATË E PËRKUSHTIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS SEKSUALE NË KONFLIKTE

Përdorimi i gjerë i përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale gjatë konflikteve të armatosura është njëra nga padrejtësitë më të mëdha, më të shpeshta dhe më të shpërfillura. Dhuna seksuale në konflikte shkakton vuajtje të pa imagjinueshme. Është e shkaktuar me qëllim që të shkatërrojë individ, familje dhe komunitete. Si pasojë, konflikti dhe jostabiliteti vazhdojnë, shpesh për gjeneratat të tëra. Por kjo nuk është një pasojë e paevitueshme e luftës. Ne përshëndesim çfarë Organizata e Kombeve të Bashkuara, shumë organizata të tjera multilaterale, si dhe shoqëria civile kanë bërë për të parandaluar këtë tragjedi njerëzore. Ne shprehim mbështetjen tonë të plotë ndaj tyre. Por për shumë kohë ata që kryen këto krime, dhe udhëheqësit e tyre të cilët i falën ata, nuk kanë marrë dënimin e merituar. Si komunitet ndërkombëtar ne mundemi dhe ne duhet të bëjmë më shumë që t'i parandalojmë dhe t'i përgjigjemi këtyre akteve barbare.

Me të drejtës ndërkombëtare humanitare prej një kohe të gjatë ndalohet dhuna seksuale në konflikte të armatosura. Dhuna seksuale poashtu paraqet një nga format më serioze të dhunës apo abuzimit e të drejtave të njeriut. Dhuna seksuale në konflikte mund ta përkeqësojë situatën e konfliktit të armatosur dhe mund ta ngadalësojë rivendosjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, siç pasqyrohet në shumë rezoluta të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Rezolutatë mbi Gratë, Paqja dhe Siguria, Fëmijët dhe Konfliktet e Armatosura, dhe Mbrojtja e Civilëve në Konfliktet e Armatosura. Ne shprehim brengosjen tonë serioze dhe të vazhdueshme rreth rolit të armëve ilegale, të cilat lehtësojnë dhe mundësojnë dhunën në baza gjinore apo aktet serioze të dhunës kundër grave dhe fëmijëve. Parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës seksuale është kusht thelbësor për zgjidhjen e konflikteve, për të mundësuar zhvillim dhe për të ndërtuar paqe të qëndrueshme. Ne duhet t'i adresojmë të gjithë faktorët të cilët i kontribuojnë dhunës seksuale në konflikte dhe të vendosim një përgjigje gjithëpërfshirëse operationale të sigurisë dhe drejtësisë, në përputhje me ligjet e aplikueshme ndërkombëtare.

Dhuna seksuale e shkaktuar në konflikte nuk duhet të konsiderohet krim i një shkalle më të ulët. Numri më i madh i viktimave asnjëherë nuk gjejnë drejtësi për vuajtjet që i kanë pësuar dhe nuk marrin mbështetjen dhe përkrahjen e nevojshme. Ne duhet të thyejmë këtë kulturë të pandëshkueshmërisë për ata të cilët kryejnë këto krime, duke i sjellur përgjegjësist para drejtësisë- si element kritik i angazhimeve tona për të parandaluar këtë krim. Nuk duhet të këtë vend strehime

për përgjegjësitë e këtyre krimeve. Ne theksojmë kontributin e rëndësishëm të tribunaleve të përziera ndërkombëtare si dhe atyre ad hoc, të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (ICC) si dhe të dhomave të gjykatave kombëtare për të parandaluar pandëshkueshmërinë duke siguruar marrje të përgjegjësisë dhe duke i dënuar përgjegjësit e dhunës seksuale në konflikte.

Ne rikujtojmë se përdhunimi dhe format e tjera serioze të dhunës seksuale në konflikte të armatosura janë krime lufte dhe përbëjnë shkelje të rëndë të Konventave të Gjenevës dhe Protokolit të Parë të tyre.

Garantimi i të drejtave të plota dhe fundamentale të grave dhe vajzave si dhe pjesëmarrja e plotë, e barabartë dhe aktive e tyre në politikë, shoqëri dhe ekonomi, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, në proceset e sektorit të drejtësisë dhe sigurisë, si dhe në aktivitete më të gjëra zhvillimore, është thelbësore për parandalimin e dhunës seksuale në konflikte. Por, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se burrat dhe djemtë janë poashtu viktimat e këtij krimi, siç janë edhe ata të cilët detyrohen të jenë dëshmitarë apo të kryjnë krime të tilla ndaj familjes së tyre apo anëtarëve të komunitetit të tyre. Angazhimet tona duhet që poashtu të shërbejnë në riorientimin e stigmës së turpit nga viktimat drejt kryerësve të këtyre krimeve, të atyre që i urdhërojnë apo i lejojnë këto krime të ndodhin.

Për këto arsye, ne zotohemi që të bëjmë më shumë rreth ngritjes së vetëdijes për këto krime, që të sfidojmë pandëshkueshmërinë që ekziston dhe të mbajmë përgjegjës kryerësit e këtyre veprave, që t'ju ofrojmë mbështetje më të madhe viktimave si dhe të mbështesim angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për ndërtimin e kapaciteteve për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës seksuale në konflikte. Ne jemi të vendur që:

- Të sigurohet që angazhimi për parandalimin e dhunës seksuale dhe përgjigjet ndaj këtyre veprave të bëhen primare dhe të kenë fondet e nevojshme që nga faza e parë dhe përgjatë gjatë përgjigjeve gjatë konfliktit dhe emergjencave humanitare.

- Të ofrohet asistencë dhe kujdes më i mirë, më gjithëpërfshirës dhe në kohën e duhur, duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe atë psiko-social, të cilat adresojnë pasojat afatgjate të dhunës seksuale në konflikte ndaj viktimave femra, meshkuj si dhe ndaj familjeve të tyre, përfshirë edhe ndaj fëmijëve të lindur si rezultat i dhunës seksuale.

- Të sigurohet që të gjitha proceset e paqes, të sigurisë dhe të ndërmjetësimit në konflikte në mënyrë eksplicite të njohin nevojën për të parandaluar, për tu përgjigjur dhe për të ulur krimet e dhunës seksuale në konflikte dhe të theksohet nevoja për të mos përfshirë këto krime në provizionet e amnistisë.

- Të promovohet pjesëmarrja e plotë e grave në të gjitha strukturat politike, qeverisëse dhe në ato të sigurisë, si dhe në të gjitha proceset vendimmarrëse, duke përfshirë në negociatat për paqe, për ndërtimin e paqes, në përpekjet e parandalimit dhe llogaridhënies, duke njohur kontributin që Planet Kombëtare të Veprimit për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mund të luajnë në këtë aspekt, si dhe të sigurohemi që proceset e tilla marrin parasysh në tërësi nevojat dhe të drejtat e grave dhe fëmijëve.

- Të përforcohen angazhimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për adresimin e dhunës seksuale në konflikte dhe ofrimi i mbështetjes së mëtutjeshme për Përfaqësuesin e Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për dhunën seksuale në konflikte si udhëheqës i veprimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër dhunës seksuale në konflikte.

- Të përforcohen dhe mbështeten angazhimet e organizatave rajonale për të parandaluar dhe për tu përgjigjur ndaj dhunës seksuale në konflikte në iniciativat e tyre në sigurimin e paqes, në ruajtjen e paqes si dhe ndërtimin e paqes.

- Të mbështeten shtetet e prekura nga konflikti për të forcuar kapacitetet e tyre për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës seksuale në konflikte dhe për të zhvilluar dhe implementuar programe të sektorit kombëtar të sigurisë dhe të reformave në drejtësi të cilat marrin parasysh në tërësi nevojat dhe të drejtat e grave dhe fëmijëve.

- Të mbështetet ofrimi i ekspertizës kombëtare dhe ndërkombëtare në rast kërkese nga qeveritë nikoqire, nga Organizata e Kombeve të Bashkuara si dhe nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare me synim ndërtimin e kapaciteteve kombëtare për ti mbaj përgjegjës kryerësit e këtyre krimeve dhe për të përmirësuar përgjigjen dhe mbështetjen ndaj viktimave dhe çasjen e tyre në drejtësi.

- Të sigurohet që doktrinën dhe trajnimet policore dhe ushtarake të jenë në përputhje me ligjin ndërkombëtar për të mundësuar një parandalim dhe përgjigje më efektive ndaj dhunës seksuale në konflikte.

- Të inkurajohet dhe përmirësohet mbledhja etike dhe e sigurtë e të dhënave dhe dëshmimeve të akteve të dhunës seksuale në konflikte për të informuar përgjigjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Të inkurajohet, mbështetet dhe mbrohet përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile, përfshirë grupet e grave si dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, që të përmirësojmë monitorimin dhe dokumentimin e rasteve të dhunës seksuale në konflikte pa frikë nga ndëshkimet, si dhe të fuqizojmë viktimat për çasje në drejtësi.

- Të mbështetet dhe inkurajohet zhvillimi i Protokollit Ndërkombëtar mbi dokumentimin dhe investigimin e dhunës seksuale në konflikte, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, me aspiratë për përmbyllje në vitin 2014.

Duke punuar së bashku, duke shkëmbyer dijen dhe përvojën, duke mobilizuar burimet dhe duke shfaqur vendosmërinë e vullnetit tonë politik global, ne jemi të përkushtuar që ti japim fund përdorimit të përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale si armë lufte. Ky lloj krimi nuk duhet të lejohet të ekzistojë më tutje. Tani është koha për veprim.